VENDIM
Nr.145, datë 8.3.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.388, DATË 31.5.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN, TË DREJTAT DHE DETYRAT E KOMISIONIT SHTETËROR TË PRODHIMIT ORGANIK"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr.9199, datë 26.2.2004 "Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve "BIO"", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.388, datë 31.5.2005 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Komisioni Shtetëror i Prodhimit Organik (KSHPO), i cili krijohet si organ ndërinstitucional, të ketë në përbërje 9 veta, konkretisht:

- Zëvendësministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	kryetar;
- Katër përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	anëtarë;
- Një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë	anëtar;
- Një përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
- Një përfaqësues nga organizatat jofitimprurëse në fushën e bujqësisë organike	anëtar;
- Një përfaqësues nga Universiteti Bujqësor i Tiranës	anëtar.".

2. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Sekretariati përbëhet nga tre anëtarë, specialistë nga drejtoritë e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të cilët përcaktohen me urdhër të Ministrit. Sekretariati përgatit dokumentet dhe materialet për mbledhjen e KSHPO-së, administron dokumentet dhe aktet, që miratohen nga KSHPO-ja, si dhe nxjerr buletinin e këtij komisioni. Mënyra e funksionimit të sekretariatit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjtes së Konsumatorit.".

3. Në pikën 8 "Detyrat dhe të drejtat e KSHPO-së janë:" bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në shkronjat "f", "h" dhe "j", fjalët "…Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit…" zëvendësohen me… "Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit…".

b) Në shkronjën "k", fjalët "…nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit…", zëvendësohen me "…nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit…".

4. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe institucionet e përmendura në pikën 1 për zbatimin e këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha